



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE



Nr. i Protokollit: 02/782

Procesverbal nga dëgjimi publik me klube sportive, biznese, OJQ, personeli shëndetësor, drejtor/eshat e shkollave, penzionist/e, fermer/e dhe përfaqësues/e të bizneseve

E mërkurë, më 17.06.2026

Kohëzgjatja e takimit: 16:00 – 18:00

Vendi i takimit: Salla e Kuvendit Komunal

Pjesëmarrës në takim ishin: Nënkyetari i Komunës - Adnan Ademi, Drejtori i Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi – Bardhyl Rushiti, Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Besnik Ahmeti si dhe Drejtori i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, Grejtalb Emini.

Rendi i ditës:

Korniza Afatmesme Buxhetore 2027-2029

Nënkyetari i Komunës, Adnan Ademi : Përshëndetje për të gjithë, mirë se keni ardhur në këtë takim. Ashtu siç jeni njoftuar përmes rrjeteve sociale, përmes faqes së Komuës, sot fillojmë dëgjimet publike për kornizën afatmesme buxhetore 2027-2029, si çdo vit edhe këtë vit po fillojmë, vetëm se këtë vit e kemi ndryshuar pak formatin nuk kemi filluar me fshatrat por me bizneset, klubet sportive, personelin shëndetësor, OJQ-të, penzionistët etje. Do të thotë që do t'i marrim kërkesat nga përfaqësuesit e institucioneve në Komunën e Shtimes.

Kjo kornizë afatmesme buxhetore nga sot nis hapat e planifikimit për vitin 2027, se çka do të vendoset në buxhet, ku bashkarisht me ju do të vendosim. Ne në vitet paraprke kur kemi mbajtur dëgjimet publike në fshatra, prioritetet i kemi vendosur të parat dhe jemi munduar që t'i vendosim në buxhet edhe në këtë mandat do të vazhdojmë njëjt. Kemi pasur çdo herë problem si qeverisje për shkak të kontratës kolektive dhe disa kontratave të tjera për shkak të borxheve, por jemi munduar që t'i menaxhojm, të njëjtën gjë po e bëjmë edhe këtë vit.

Këtë vit buxheti i Komunës së Shtimes do të jetë afër 12 milion, të cilat do të ndahen në disa kategori, por e rëndësishme është që sot ne të flasim për investimet kapitale.

Ju e dini që komuna e Shtimes për katër vite me rradhë ka shkuar duke i rritur subvencionet dhe e them me përgjegjësi të plotë që ka mbërritur tavanin.

Ne zotohemi këtu si qeverisje se të gjitha kërkesat të cilat vijnë si nga ju si nga subjektet politike, si nga asambleistët dhe qytetarët t'i proretizojmë dhe t'i vendosim në buxhet.

Së pari po i'a kaloj fjalën Drejtorit të Financave, Besnik Ahmeti, që të bëjë një laborim të shkurtër të buxhetit më pas fjala do të kaloj tek ju që t'i paraqitni kërkesat e juaja.

Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Besnik Ahmeti: Faleminderit Nënkyetar edhe një herë përshëndetje për të gjithë. Nënkyetari po thuajse e përfshiu të gjithë qarkoren buxhetore për vitin 2027-2029, buxheti është afër 12 milion euro.

Ky buxhet pas përfundimit të diskutimeve publike, shpërndahet në 5 kategori, ku është kategoria e pagave 7.3 milion, mallra dhe shërbime është 1.5 milion, subvencione 500 mijë, shërbime komunale janë 520 mijë dhe afër 2.3 milion janë shpenzime kapitale. Këto nuk janë finale, mund të lëvizin varësisht në sa mund t'i mbrojm kufinjët para Ministrisë së Financave, përkatësisht departamentit të buxhetit.

Pasi që të përcaktohen kufinjët buxhetor për komunën e Shtimes, të gjitha drejtoritë, të gjitha institucionet e komunës së Shtimes lëshohet qarkorja e dyte datës 15 gusht dhe prap do të mbajm diskutim publike në mënyr që t'i harmonizojmë më së miri.

A është buxhet i mjaftueshëm për komunën e Shtimes, sigurisht që jo edhe më shumë po të jetë sigurisht që komuna jonë ka vend për investime, por si komunë kaq e kemi buxhetin, duke pasur parasysh që Ministria e Financave në bazë të qarkores buxhetore i ka disa parametra që i përcakton kufinjë duke u bazuar në pozitën gjeografike, në numrin e banorëve, numrin e komuniteteve dhe disa faktorë të tjerë dhe si përfundim i të gjitha këtyre ka ardh si përfundim që buxheti i komunës së Shtimes, për vitin 2027 është afro 12 milion.

Unë nuk po vazhdoj më shumë por po e hap debatin sa i përket këtij dëgjimi publik, kështu që mund të vazhdoni dhe t'i paraqitni kërkesat e juaja, faleminderit.

Kërkesat :

- Klesta Krasniqi : Mendoj që pjesa e turizmit për komunën e Shtimes është shumë më rëndësi, akoma nuk kam parë një faqe në instagram apo ndonjë rrjet social tjetër, që flet për turizmin e Shtimes. Të gjitha pjesët e turizmit në Shtime duhet të promovohen, sepse nuk është vetëm një biznes në Shtime që duhet të shkojnë njerëzit të pijnë kafe apo të konsumojnë ushqim por ka më shumë. Duket që buxhet që bënë promocionin e të gjitha gjërave të bukura që ka Shtimja, një udhëtim, një ujëvarë, një restorant, mund të vijnë qytetarë nga e gjithë Kosova që të vizitojnë bukurit e vendit si Topilla, Duga apo edhe vendet e tjera. Është e rëndësishme që të kemi një buxhet të vogël për të bërë faqe ku mund të ofrohen shërbimet e turizmit në Shtime.

Diçka tjetër e cila më duke mua shumë me shumë rëndësi është lëvizja e qytetarëve, lëvizja qytetare në Shtime është shumë e bllokuar dhe është e varur nga privati, çfarë bënë komuna e Shtimes për të mbajtur shkollën dhe njerëzit që duan të vijë nëpër fshatra, është e bllokuar totalisht tek privati. A mund të ketë një bashkëpunim privat-publik? Nuk e di si e zgjidhni këtë bisedë por unë kam një pyetje edhe sa ditë do të fillojnë punën 40 punëtor tek unë, si do të vijnë ata punëtorë në Dugë ? Nëse duan disa gra të vijnë në Dugë me fëmijë si do të vijnë ?

Dmth si organizohet pjesa e transportit në Shtime. A është e gjitha privat?

Pjesa tjetër është edhe pastërtia e qytetit, është shumë e ndotur, nuk e di as çfarë fiale të përdor, ka një pamje shumë shumë të keqe. Për mendimin tim Shtimja do një dorë të fort, ndoshta dënime të forta, ju duhet të bëni zgjidhje si komunë.

Industria e turizmit është shumë e rëndësishme nuk e di a e kuptoni se sa e rëndësishme është turizmi për Shtimen. Unë kaq kisha faleminderit.

- Berham Gashi - Drejtori i shkollës "Idriz Ajeti" Pjetërshticë :
Rregullimi i rrethojës së Shkollës, (oborrit të Shkollës), 15.000 euro
Parkingu i shkollës, (Mbrenda oborrit), 6.000 euro
Veshja me dritare dhe dy dyer (Hyrja e sallës së sportit), 4.500 euro
Parku i lodrave (oborri i shkollës), 1.500 euro
- Floreta Abazi Gashi – Drejtoreshë në shkollën "Emin Duraku" : Normalisht që janë bërë investime infrastrukturore por prap kemi kërkesa që ta plotësojmë infrastrukturën shkollore dhe ta mundësojmë që të zhvillohet një proces edukativo-arsimor sa më i rregullt dhe me kushte të përshtatshme për nxënësit. Konkretisht disa kërkesa janë adresuar në DKA dhe kemi shikuar mundësinë përmesë ministrisë me pas mundësi subvencionimi prej atje lartë por këto kërkesa do t'i delegoja edhe tek ky takim.
Atëherë, unë si drejtoreshë e shkollës "Emin Duraku", propozoj që një investim në shkollën e Davidovcit është i nevojshëm, në pjesën sanitare por gjithashtu edhe një investim i brendshëm i cili kërkon ndërrimin e dymve dhe rregullimin e infrastrukturës së murit apo diçka të tillë po gjithashtu edhe të dyshemeve. Njëkohësisht do ta potencioja edhe radiatorët apo sistemi i ngrohjes është i mobilizuar në formën siç kemi arritur ta menaxhojmë ne, kemi zhvendosur disa radiator por ata besoj që janë nevojë edhe të futen në një projekt edhe më të gjërë, në këtë rast do të jepte rezultate me të vërtetë pozitive.
Pastaj kemi edhe kërkesë të që të investohet në shkollën amë këtu në Shtime, në ciklin e ulë, një investim i brendshëm gjithashtu është i nevojshëm për shkak se shkolla ka një strukturë që ka një kohë të gjatë që është ndërtuar dhe ka nevojë për një investim në sistemin e rrymës. Gjithashtu kemi nevojë edhe të bëhet ndërrimi i dritareve.
- Beadin Rexhepi - OJQ : Pse nuk është realizuar projekti për Ujëvarat e Mollopolcit?
Sa i përket komisionit për ndarjen e subvencioneve mendoj që komisioni të cilin e keni krijuar është jo profesional dhe tendencioz.
- Milaim Rushiti – Observatoriumi : Unë i kam 3 kërkesa të cilat dua të parashtroj sot para jush, e para është tek observatoriumi kupola është duke pikuar dhe është e nevojshme të intervenohet sa më parë pasi që ka paisje të cilat janë shumë të vlershme dhe mund të dëmdohen.
Parkingu tek Observatoriumi është i nevojshëm të rregullohet pasi që ka shumë vizitorë nga e gjithë Kosova dhe jo vetëm, prandaj është i nevojshëm shumë parkingu.
Dhe e fundit është vendosja e dritave prap tek i njëjti vend pra tek Observatoriumi, gjithësej nevoiten 12 drita të vendosen.
- Albiona Ahmeti – Drejtoreshë e shkollës së mesme të ulët "Emin Duraku" : Zgjerimi i trotuarit, vendosja e e mbrojtësve përgjatë rrugë që të qon tek shkolla, rruga "Skender Salihaj", sidomos në kohën e dimrit është rrezik për fëmijët.
Rritja e buxhetit për mirëmbajtjen e objekteve shkollore, renovimi i sallës së edukatës fizike që është në gjendje tmerruese. Ndarja e mjeteve për paisje dhe inventar shkolle sipas nevojave institucionale. Po ashtu kisha dasht që të shikohet mundësia nëse është e mundur,

një kompani private të pastrimit të kontraktohet në shkolla, që t'i ndihmojë ato shkolla të cilat e kanë një staf shumë më të vogël dhe një hapësirë më të madhë.

- Faton Ahmeti – Drejtori i shkollës “Abdullah Shabani”, Carralevë :
Të funksionohet salla e sportit
Rrërimi i shkollës së vjetër
Një parking për mësimdhënësit
- Valentina Ferati Halili – Drejtoreshë në shkollën “Skënderbeu”, Reçak : Renovimi i plotë i tavanit të shkollës
Sanimi i dyshemes
Renovimi i banjove
Renovimi i zyrës së Drejtorit të shkollës
Dyert e shkollës janë të dëmtuara dhe duhet të ndërrohen
Oborri i shkollës duhet të rregullohet
Sa i përketë sallës së edukatës fizike, më nevoiten datat e sakta se kur do të përfundojë
- Adil Qorrolli – Drejtor i shkollës “Lasgush Pogradeci”, Muzeqinë : Vazhimi i rrethojës së shkollës në fshatin Gjyrkofc
Regullimi i oborrit në fshatin Rashincë
Finalizimi i sallës së sportit në Muzeqinë
Izlomi i kulmit të shkollës në fshatin Gjyrkofc
Ndërtimi i sallës së sportit në Gjyrkofc
Në Muzeqinë renovimi i komplet shkollës pasi që është tepër e nevojshme
Muret e të gjitha shkollave kanë nveojë që të lyhen
Shkollat kanë nvojë që të paisen me kabinete teknologjike por edhe me kabinete të tjera është tejet e nevojshme
Po ashtu para një jave një shi i cili ra, kulmi i shkollës së Muzeqinës ka filluar të levizë, ju kisha lut që të dilni dhe ta shikoni atë kulm sa nuk ka rënë i tëri.
- Hysen Hoxha – Penzionist : Kërkesat për lagjen “Hoxhë Sinani”, është bërë në dëgjimin publik në vitin 2024, ka pas të realizohet këtë vit, por nuk është, ne mërgimtarët i gëzohemi çdo suksesi, çdo punë të mirë që bëhet në të gjithë qytetin. Për 2027, nëse është e mundur në investime kapitale apo në investimet nga niveli qendror, nga ministria e bujqësis, për kanalet kulluese, dikun rreth 700m, nëse nuk ka buxhet mjaftueshëm për 700m, do të ishte mire sëpahu me 300m.
- Refki Kadriu – Bletar : Vitin e kaluar spërkatja është bërë në kohë të gabuar, nëse ka mundësi këtë vit të bëhet në një kohë pak më të përshtatshme pasi që vitin e kaluar na keni dëmtuar. Të bëhet spërkatja mbas mbrëmjes.
Dhe po ashtu nëse ka mundësi të shikohen pak kushtet e bletarëve në komunën e Shtimes, të mund të ndihmohen.

Procesmbajtës,
Gentiana Mehmeti



Lista e pjesëmarrësve në konsultimin publik për Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029.

(Me klube sportive, biznese, OJQ, persoelin shëndetësor, drejtor/eshat e shkollave, pensionist/e, fermer/e dhe përfaqësues/e të bizneseve)

Shtime, 17.6.2026 (e mërkurë)

Nr.	Emri dhe mbiemri	Institucioni	Nënshkrimi
1.	HYSEN HOVHA	AMBIENTACIST	Hovha H.
2.	Behram Gashi	"DIZIE NJETI"	B-Gashi
3.	Faton Ahmeti	"Abdullah Shabani"	Ahmeti
4.	Albion Ahmeti	"Emin Duraku"	A. Ahmeti
5.	Flore Abazi Gashi	Shf. "Emin Duraku"	Flora
6.	Valentina Halili-Ferati	"Sh.f.m.y "Skënderbeu"	V. Halili
7.	KRASNIJA Klesha	Road Rebranding	K. Klesha
8.	Erza Salija	Këshilltare Komunalet	Erza
9.	Albana Ramadani	Këshilltare Komunalet	Ramadani
10.	ADELINA SHABANI	Këshilltare Komunalet	A. Shabani
11.	Behadin Rexhepi	FERMER, BIZNIS OJQ	B. Rexhepi
12.	REFKI TADRIU	FERMER BGETAR	R. Tadiu
13.	Emine Jetishi	Akademia	Emine
14.	Besnik Seferi	Këshilltar në K. Komunalet	B. Seferi
15.			
16.			